



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2021” TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME
TË EVADUARA 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2021” TË USHTRUAR NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE**

Tiranë, më 15.09.2021

PËRMBAJTJA:

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	Përmbledhje ekzekutive	3
	I/1. Hyrje	3
	I/2. Objektivat e auditimit	4
	I/3. Qëllimi i auditimit	4
	I/4. Metodologjia auditimit	4
	I/5. Konkluzione	4
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	4
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	4-13
	III/1. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	4-13
IV.	Konkluzione dhe Rekomandime	14-18

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave (këtu e në vazhdim DPA) : “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2021”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si: vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisione disiplinore për dhënien e masave disiplinore.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

Në përfundim të procesit të punës audituese në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura nga subjektet në fazën e Projekt Raport të Auditimit, gjetjet e konstatuara të cilat janë reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, situata e zbatimit të rekomandimeve në 1 subjekt të audituar, paraqitet si vijon:

Nga ana e KLSH, me shkresat përcjellëse në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 23 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa, ku nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe janë në proces zbatimi 12 masa organizative.

I/1 HYRJE

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2, e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Programit të Auditimit nr.878 prot., datë 04.08.2021 me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2021”.

Auditimi është kryer nga:

1. M.H. (përgjegjës grupi)
2. R.A., anëtar

- Çështjet e Audituar:

1. Hartimi i programit (Planit të veprimit), si dhe respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (shkronja “j” e nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”).

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

2. Realizimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

3. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

I/2 Objekti i auditimit IT:

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (terren) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, etj.

I/3 Qëllimi i auditimit IT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4 Metodologjia e auditimit:

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

I/5 Konkluzione

Nga përfundimi i punës në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekteve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, rezulton se:

Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa, ku nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe janë në proces zbatimi 12 masa organizative.

II- Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i realizimit të rekomandimeve është mbi 40%, për disa nga masat për të cilat janë në proces zbatimi ose janë zbatuar pjesërisht duhet akoma më shumë punë për realizimin në nivelin 100% të rekomandimeve.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2019 – 30.06.2020.

Auditimi ka filluar më datë 06.08.2021

Auditimi ka përfunduar më datë 30.08.2021

III.1 Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

Nga ana e KLSH, me shkresën nr.821/4 prot, datë 22.02.2021 për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 23 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa, ku

nga të pranuarat janë zbatuar 9 masë, janë në proces zbatimi 12 masa organizative dhe janë zbatuar pjesërisht 2 masa organizative.

III.1.1 Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

DPA me marrjen e raportit përfundimtar dhe rekomandimeve, ka hartuar planin e veprimit “Për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH”, për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dhe ka përcjellë në KLSH brenda afatit ligjor me shkresën nr.464/14 prot. datë 12.03.2021 (DPA). Në plan janë përcaktuar strukturat përgjegjëse dhe masat që do të ndërmerren për secilin nga 23 rekomandimet.

III.1.2 Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecures së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

DPA me shkresën nr.464/22 prot. datë 24.08.2021 ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, në zbatim të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Akt Verifikimi nr.1, datë 30.08.2021 protokolluar nr.464/23 prot DPA datë30.08.2021. si dhe është trajtuar në faqen 3 të Projekt Raportit të auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara 6-mujorin e parë të vitit 2021” mbi të cilin janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit nr.464/26 prot. datë 10.09.2021.

Pretendimi i Subjektit :

a)Raporti nga ana e DPA për realizimin e rekomandimeve është protokolluar në sekretarinë tonë me Nr. 464/22 më datë 24.08.2021

Qëndrim i grupit të auditimit

Në lidhje me këtë Observacionin grupi i auditimit sqaron se: Ky observacion merret parasysh, mbasi u verifikua se ka ardhur në protokollin e KLSH me nr.878/3 prot. datë 25.08.2021 dhe ndryshimet janë reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit .

III.1.3 Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Nga të pranuarat	Nr.	%
Zbatuar	9	40
Zbatuar pjesërisht	2	8
Në proces	12	52
Nuk janë zbatuar	0	0

Nga ana e KLSH me shkresën nr. 821/4 prot, datë 22.02.2021, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 23 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa, ku

nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa ose 40%, janë zbatuar pjesërisht 2 masa ose 8% dhe janë në proces zbatimi 12 masa organizative ose 52%.

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar DPA, 23 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 23 masa. Nga masat e pranuarat janë zbatuar 9 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe janë në proces zbatimi 12 masa organizative.

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të rekomandimeve:

1.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk disponon rregullore të teknologjisë së informacionit ku të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për përdorimin dhe administrimin e infrastrukturës dhe sistemeve të informacionit.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masat për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje mbi teknologjinë e informacionit në institucion ku të përcaktohen procedurat që do të ndiqen nga punonjësit në drejtim të sistemeve dhe sigurisë IT.

1.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka miratuar rregulloren për sistemet TI me nr.6997 prot, datë 22.06.2021 ku janë përcaktuar procedurat që do të ndiqen nga punonjësit në drejtim të sistemeve dhe sigurisë IT.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se shërbimet që AKSHI duhet t'i ofrojë DPA-së nuk janë ende të rregulluara dhe përcaktuara në një marrëveshje të nënshkruar nga palët, me qëllim përcaktimin e nivelit të shërbimit që AKSHI duhet ti ofrojë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet dy institucioneve, në opinion të grupit të auditimit, përbën risk për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve të Drejtorisë TIK në DPA.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një marrëveshjeje dypalëshe mbi shkallën e suportit që njësia e IT dhe vetë AKSHI do t'i sigurojë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, me qëllim mirë përcaktimin e detyrimeve dhe përgjegjësisë të ndërsjella.

2.2. Nga auditimi rezulton që: DPA i ka dërguar shkresë zyrtare me nr.4406 prot, datë 20.04.2021 AKSHI-t, por nuk ka marrë një përgjigje deri tani.

Rekomandimi është në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Auditimi i Brendshëm në këtë institucion nuk ka planifikuar dhe kryer misionet auditimi në sistemet e TI-së, si dhe nuk ka zhvilluar burimet njerëzore me njohuri të mjaftueshme për auditimin e Teknologjinë së Informacionit.

3.1. Rekomandimi: DPA të marrë masa për zhvillimin e burimeve njerëzore të Auditimit të Brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe mbulimin me auditim të brendshëm të sistemeve TI, drejtorisë TI në DPA si dhe përdoruesit e sistemeve informatike në përputhje me përcaktimet ligjore

3.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masa për zhvillimin e burimeve njerëzore të Auditimit të Brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe mbulimin me auditim të brendshëm të sistemeve TI, të cilën e ka dërguar tek DAP me shkresë zyrtare me nr.7733 prot, datë 08.07.2021

Rekomandimi është në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk disponon procedura mbi menaxhimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin. Në mungesë të

këtyre procedurave të shkruara, problemet dhe incidentet për periudhën nën auditim menaxhohen mbi bazë ngjarjesh të cilat raportohen nëpërmjet komunikimeve elektronike, pra jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet TI pa u dokumentuar këto procese.

Gjithashtu DPA nuk disponon procedura për iniciimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive për kryerjen e ndryshimeve.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masat e nevojshme për hartimin e procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve, si dhe procedurave për iniciimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive për kryerjen e ndryshimeve.

4.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masa për hartimin e procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve në rregulloren e sistemeve IT të miratuar me nr.421 Prot, datë 22.06.2021.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si institucion i specializuar, që mbledh, përpunon, administron, ruan dhe shërben pasurinë arkivore në funksion të njohjes me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe e drejta për shërbim me dokumente për qëllime studimore-shkencore, nuk disponon një infrastrukturë BCC (Business Continuity Center). DPA nuk ka plan masash dhe procedurash për vazhdimësinë e proceseve dhe rimëkëmbjes nga katastrofat në rastet e dështimit të qendrës së të dhënave primare për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit, duke krijuar risk për humbjen e të dhënave, veprim në kundërshtim me pikën 1 të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave bashkëpunim me AKSHI-n, duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme, të marrë masa për ndërtimin e një Business Continuity Center dhe hartimin e Planit të Vazhdimësisë dhe Planit të Rikuperimit, duke përfshirë planet për backup dhe rimëkëmbjen nga katastrofat për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, hartimin e planit të sigurisë së informacionit dhe implementimin e tij.

5.2. Nga auditimi rezulton që: DPA me shkresën nr.464/14 prot. ka marrë masat e nevojshme për backup dhe rimëkëmbjen nga katastrofat për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, hartimin e planit të sigurisë së informacionit dhe implementimin e tij. Është në proces për verifikimin e backup dhe më pas do të kryhen testimet për Disaster Recovery.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPA nuk ka analizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat për trajnim të punonjësve për Sigurinë e Informacionit, në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.

6.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të hartojnë plane për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sigurinë e informacionit në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.

6.2. Nga auditimi rezulton që: DPA në rregulloren e sistemeve IT të miratuar me nr.421 Prot, datë 22.06.2021, ka marrë masat për përcaktimin e strukturave të cilët do të rekomandojnë mbi nevojën e trajnime në lidhje me sigurinë e informacionit në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni,

Rekomandimi është në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- DPA nuk ka një mekanizëm efektiv dhe të mirë dokumentuar të vlerësimit të riskut të sigurisë së informacionit.
- Vlerësimi i riskut i kryer nga DPA nuk mbulon të gjitha risqet e brendshme dhe të jashtme që vinë nga TI.
- DPA nuk mat efektet dhe ndikimet e mundshme të dëmtimeve në sigurinë e informacionit.
- DPA nuk ka mekanizma për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm.

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masa për hartimin e regjistrit të risqeve që kërcënojnë infrastrukturën TI si dhe ngritjen e mekanizmave për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm.

7.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masa për dokumentimin e vlerësimit të riskut të sigurisë së informacionit në rregulloren e sistemeve IT është në pikën 3.3 analiza e riskut dhe janë në proces për hartimin e regjistrit të risqeve.

Rekomandimi është në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk ka Politika të Sigurisë së Informacionit dhe një drejtim strategjik të përshtatshëm si mbështetje për sigurinë e informacionit.

8.1. Rekomandim: DPA të marrë masa për kalimin e sistemit të saj në domain gov që ofron AKSHI dhe të zbatojë Politikën e Sigurisë së Informacionit dhe drejtimin strategjik të këtij rrjeti.

8.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka dërguar shkresë zyrtare me nr.8793 prot. Datë 10.08.2021 AKSHI-t, por nuk ka marrë një përgjigje.

Rekomandimi është në proces zbatimi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se protokoli i VPN PPTP dhe L2TP i përdorur në routerin Mikrotik 951Ui-2HnD për aksesit e përdoruesve nga jashtë rrjetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivës për tu lidhur me rrjetin e brendshëm nëpërmjet VPN nuk siguron nivelin e duhur të sigurisë dhe mbart risk në akses të pa autorizuar.

Në konfigurimet e firewall shikohet që nuk janë marrë masat e duhura për të garantuar sigurinë e hyrjeve dhe tentativave nga jashtë si dhe për të parandaluar sulme ose viruse që sulmojnë IP të caktuara

Në listën e firewall shikohet që ka të krijuar rules të cilat bëjnë forward trafikun nga IP e dedikuar në rrjetin e brendshëm DST-NAT dhe nuk ka të aktivizuar opsionin e ruajtjes së log-ve.

Nga auditimi i exportit të konfigurimit (databazës) së Routerit të model Mikrotik 951Ui-2HnD vërehet që ai është i hackuar dhe brenda janë lejuar komunikime me IP të jashtme nëpërmjet protokolleve SOCKS dhe UPNP

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masa për:

- resetimin në Routerit model Mikrotik 951Ui-2HnD, të bëhet upgrade firmware dhe të rikonfigurohet edhe njëherë.
- ndryshimin në Routerit model Mikrotik 951Ui-2HnD protokoli PPTP dhe L2TP në IPSec pasi nuk sigurojnë nivele sigurie për lidhjen e përdoruesve nga jashtë.
- limitimin në Routerit model Mikrotik 951Ui-2HnD SNMP Community vetëm për subnetin monitorues në rastin që ka një server i cili merr të dhënat për arsye monitorimi.
- krijimin në Routerit model Mikrotik 951Ui-2HnD rules në firewall të cilët detektojnë dhe bllokun kur një IP tenton disa mbi 10 connection në sekondë me një IP të caktuar.
- aktivizimin në Routerit model Mikrotik 951Ui-2HnD log të detajuar për të monitoruar të gjitha lidhjet në këto shërbime.

9.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë të gjitha masat për kryerjen e konfigurimeve përkatëse pas verifikimeve përkatëse.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Switch cisco SG350X nuk është i konfiguruar mbështetur në praktikat më të mira të sigurisë duke përdorur për akses si Administrator emrin CISKO duke lënë si portë aksesimi për protokollin SSH portën standarde (default) TCP 22.

10.1. Rekomandimi: DPA të marrë masa për ndryshimin e konfigurimit të switch cisco SG350X në përputhje me praktikat më të mira të sigurisë duke përdorur për akses si Administrator një emër tjetër me siguri të nevojshme si dhe të ndryshohet porta e aksesimit për protokollin SSH nga porta 22 në një tjetër portë.

10.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë të gjitha masat për kryerjen e ndryshimeve të konfigurimit të switch cisco SG350X në përputhje me praktikat më të mira të sigurisë

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Shërbimet e ofruara me anë të Teknologjisë së Informacionit në DPA mbështeten në një infrastrukturë IT (rrjeti network) të amortizuar, shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektivën e zhvillimeve të përcaktuara në planin strategjik 2020-2030.

- Ambientet e mbajtjes se serverave të DPA-së nuk plotësojnë kushtet teknike të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverëve” (versioni 1.0, datë 02.12.2008). Dhoma e serverave si vendi fizik ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverat dhe pajisje të tjera ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave është pika më e ndjeshme e sistemeve të teknologjisë së informacionit të një institucioni.

11.1. Rekomandim: DPA për mbështetjen e perspektivës së zhvillimeve institucionale të përcaktuara në planin strategjik 2020-2030 nga Teknologjia e Informacionit të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një infrastrukturë IT (rrjeti network dhe dhoma serverave) në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga AKSHI.

11.2. Nga auditimi rezulton që: DPA me shkresën nr.507 prot., datë 03.08.2021 ka marrë masa duke ngritur grupin e punës, për studimin e tregut në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga AKSHI.

Rekomandimi është në proces zbatimi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sistemi i hyrje daljeve DPA nuk garanton akses të sigurtë pasi në sistem rezultojnë

- Në 14 raste ka karta akses pa emër e mbiemër në sistem.
- Në 44 raste Llogari në akses pa emër ose përdorimi i numrave.
- Në 2 raste me status *active* pa të dhëna të plota.
- Në 3 raste me status *inactive* (data issue dhe aktivizimit e njëjtë).
- Në 9 raste pa status dy prej tyre kanë datë aktivizimi.
- Në 430 raste pa role përdorues.
- DPA nuk përdor sisteme TI për akses të kontrolluar sigurie të dhomave të arkivimit dhe rafteve.

Nga verifikimi i sigurisë në ambienteve të DPA dhe arkivave në rrethe rezultoi se:

- Siguria fizike në Godinat e DPA (ambientet e brendshme) ka risk të komprometohet, pasi mungesa e kamerave në ambienteve të brendshme mbart riskun e humbjes së dokumenteve e modifikimit të tyre (rasti i humbjes së një vule në vitin 2019 dhe ri gjetjes së saj pa gjetur autorin).
- Niveli i përdorimit të Teknologjisë së Informacionit për krijimin e kushteve të nevojshme (temperaturës, lagështirës, mbrojtja kundër zjarrit dhe sigurisë) në ambienteve të ruajtjes e dokumenteve është i ulët.

12.1 Rekomandimi:

1- DPA të analizojë nivelin e sigurisë së aksesit në ambienteve të saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar ndaj objekteve nëpërmjet:

- Ngritjes së një sistemi aksesit të përqendruar e të sigurt i cili duhet të përfshijë edhe aksesin e dhomave të arkivimit dhe rafteve
- Shtrirjes së kontrollit të ambienteve të brendshme dhe jashtme me sisteme CCTV.

2- DPA të marrë masa për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit në krijimin e kushteve të nevojshme në ambientet e arkivimit për mbajtjen e niveleve të duhura të temperaturës, lagështirës, si dhe sigurimit të mbrojtjes kundër zjarrit dhe sinjalizimit automatik të parametrave të tyre.

12.2.Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masa për përfshirjen e matësave të temperaturës dhe lagështirës me sistem të përqendruar në investimet e reja të kryera në vendruajtjen Shkozë gjithashtu është përfshirë në investim edhe sigurimit të mbrojtjes kundër zjarrit si edhe aksesin e dhomave të arkivimit dhe raftëve.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

13. Gjetje nga auditimi:Nga verifikimi i user-ave të katalogut, u konstatua se në fushën “ID” të user-ave, mungojnë ID=1, ID=15, ID=16 dhe ID=17. Ndërsa nga verifikimi i user-ave publik, u konstatua se mungojnë gjithsej 262 ID përdoruesish. Mungesa e këtyre ID-ve tregon se këto user-a janë fshirë. Nëse një user e mbaron objektin për të cilin është krijuar, ai duhet të bëhet “disable”, dhe jo të fshihet pasi ndikon në humbjen e gjurmës audituese.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në vijimësi, me mbarimin e objektit të krijimit të user-ave, t'i çaktivizojë ata pa i fshirë nga sistemi, me qëllim ruajtjen e gjurmës audituese.

13.2.Nga auditimi rezulton që:

DPA ka marrë masa për shtimin e buton “çaktivizo” në nivel përdoruesi të brendshëm.

Rekomandimi është zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i fushave të plotësuara për user-at e katalogut, u konstatua se:

- Tek fusha “email”, i njëjti email është përdorur për dy user-a të ndryshëm.

- Në një rast, fusha “name”, është e plotësuar me një adresë email-i, e cila është e njëjtë me fushën “email”, duke mos ditur se cili është punonjësi me këtë user.

Nga verifikimi i fushave të plotësuara për user-at publik, u konstatua se:

- Në 19 raste, i njëjti individ paraqitet me dy numra letërnjoftimesh të ndryshme.

- Në 24 raste, i njëjti numër letërnjoftimi është përdorur për dy user-a të ndryshëm, duke evidentuar faktin se sistemi nuk e parandalon përdorimin e të njëjtit numër letërnjoftimi, fushë e cila është e vetmja që përfaqëson një të dhënë unike për përdoruesit, për disa user-a. Edhe pse nga verifikimi i detajuar, user-at me të njëjtën numër letërnjoftimi praktikisht janë i njëjti individ, fakti që ndryshon minimalisht një karakter, bën që sistemi ti njohë si dy user-a të ndryshëm, çka vërteton se i njëjti numër letërnjoftimi mund të përdoret për dy apo më shumë user-a.

- Numri i letërnjoftimit, si fusha e vetme që përfaqëson një të dhënë unike për përdoruesit, e cila mund të bëjë identifikimin e tij, nuk ka mekanizëm kontrolli të input-it.

Në vlerësim të grupit të auditimit, elementët e mësipërm ndikojnë në rritjen e riskut të cenimit të sigurisë së sistemit, pasi user-at nuk janë unik, e për pasojë nuk janë plotësisht të identifikueshëm.

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të analizojë elementët e pasaktësisë të user-ave dhe të marrë masa për eliminimin e tyre në vijimësi.

14.2.Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masat e analizimit të elementëve të pasaktësisë së user-ave dhe për eliminimin e tyre.

Rekomandimi është në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi:Nga verifikimi i roleve dhe përgjegjësive të user-ave të katalogut, u konstatua se ato nuk janë të përcaktuara në bazë të funksionit apo pozicionit të punës. Për pozicione të njëjta pune, rolet nuk rezultojnë të jenë gjithnjë të njëjta. Gjithashtu u konstatuan raste ku për të njëjtin pozicion pune, disa punonjës kanë user ndërsa disa jo.

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masa për krijimin e një rregulloreje për përcaktimin e roleve të user-ave sipas pozicionit që punonjësit mbulojnë në institucion.

15.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masa për krijimin e një rregulloreje me nr6997 prot., datë 22.06.2021 për përcaktimin e roleve të user-ave sipas pozicionit që punonjësit mbulojnë në institucion.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan user-a, të cilët edhe pse kanë përfunduar objektin e tyre si user-a (në këtë rast, nuk janë më në marrëdhënie pune), vazhdojnë ende të jenë aktiv, pra nuk janë bërë “disable”, veprim i cili përbën risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem duke mos lënë gjurmë mbi aktivitetin që kanë kryer.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masat për çaktivizimin e atyre user-ave të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.

16.2. Nga auditimi rezulton që: DPA me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara, ka marrë masa për çaktivizimin e user-ave të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

17. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi me teknikat CAAT i të dhënave të katalogut dhe fototekës të vëna në dispozicion në formatin CSV si dhe testimet e sistemit, u konstatua se fushat “viti”, “numri i fondit”, “numri i inventarit”, “sasia e dosjeve”, “sasia e fletëve” dhe “numri i kutisë”, të cilat logjikisht duhet të përmbajnë numra, pranojnë si input-e edhe karaktere shkronja, çka tregon se sistemi nuk ka mekanizmat e nevojshme për kontrollin e input-it për këto fusha, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta.

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim evidentimin e të gjitha fushave të sistemit, të cilat kanë nevojë për vendosjen e mekanizmave për kontrollin e input-it dhe aplikimin e këtyre kontrolleve në sistem.

17.2. Nga auditimi rezulton që: DPA me shkresë nr.464/13 datë 12.03.2021 ka marrë masa për ngritjen e një grupi pune dhe ka evidentuar të gjitha fushat e sistemit të cilat kanë nevojë për vendosjen e mekanizmave për kontrollin e input-it dhe në përmirësimin e ardhshëm të sistemit të kryhen ndërhyrjet përkatëse.

Rekomandimi është në proces zbatimi

18. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi me teknikat CAAT i të dhënave të katalogut dhe fototekës të vëna në dispozicion në formatin CSV, u konstatua se numri ID i veprimit, është progresiv rritës, por jo i vazhdueshëm dhe pa ndërprerje, pra ka mungesa, çka tregon për fshirje të dhënash. Për këto fshirje të dhënash, nga ana e punonjësve të DPA nuk është mbajtur dokumentacioni i nevojshëm që të tregojë gjurmën audituese të këtyre veprimeve, duke ndikuar në sigurinë e të dhënave.

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në vijimësi të dokumentojë veprimet mbi fshirjet e mundshme të rekordeve të hedhura duke ruajtur gjurmën audituese, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi rregullsinë e përdorimit të sistemit.

18.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masa për dokumentimin e veprimeve mbi fshirjet e mundshme të rekordeve të hedhura duke ruajtur gjurmën audituese, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme, mbi rregullsinë e përdorimit të sistemit duke vendosur opsionin “histori” për ruajtjen e ndryshimeve.

Rekomandimi është zbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Nga kryqëzimi i të dhënave të katalogut me user-at e katalogut, u konstatua se user-i “erenbertr@gmail.com”, i cili rezulton të ketë hedhur të dhëna në katalog, nuk është pjesë e user-ave të nxjerra nga sistemi.

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të verifikojë arsyen e krijimit të user-it “erenbertr@gmail.com”, si dhe veprimtarinë e tij. Gjithashtu të evidentojë përgjegjësitë

individuale për krijimin e këtij user-i, si dhe të marrë masat e nevojshme kontrolluese për mos përsëritjen e kësaj problematike, pasi ekzistenca e user-ave të paautorizuar përbën risk për çënimin e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave të sistemit.

19.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masa për mos krijimin e user-ave me mail personal. Useri “*erenbertr@gmail.com*” është krijuar për testim në fazën fillestare për teste.

Rekomandimi është zbatuar plotësisht

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk ka një rregullore të miratuar për ruajtjen, kontrollin dhe analizimin periodik të log-eve të sistemit, me qëllim verifikimin e ndërhyrjeve të pa autorizuar, dhe parandalimin e veprimeve të cilat mund të komprometojnë të dhënat e administruara nga DPA. Log-et e sistemeve analizohen vetëm nëse ka ndonjë raportim për ndonjë incident në rrjet.

20.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masat për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje për ruajtjen, kontrollin dhe analizimin periodik të log-eve të sistemit, me qëllim verifikimin e ndërhyrjeve të pa autorizuar, dhe parandalimin e veprimeve të cilat mund të komprometojnë të dhënat e administruara nga DPA.

20.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masa për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje për ruajtjen, kontrollin dhe analizimin periodik të log-eve të sistemit, me qëllim verifikimin e ndërhyrjeve të pa autorizuar, dhe parandalimin e veprimeve, në rregulloren e sistemeve IT të miratuar me nr.421 Prot, datë 22.06.2021.

Rekomandimi është në proces zbatimi

21. Gjetje nga auditimi: Nisur nga vlerësimi i strategjisë institucionale, si dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e teknologjisë së informacionit, konstatohet se ka mos përditësim apo mungesë e akteve rregullatorë në lidhje me krijimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentit elektronik. Në kreun V të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, evidentohen elementë për dokumentet e numerizuara. Për sa i përket procesit që DPA zhvillon, grupi i auditimit vlerëson se kjo bazë ligjore ka nevojë për plotësime, ndryshime apo përshtatje me situatën aktuale të zhvillimit teknologjik, pasi nuk ekziston e gjithë baza e nevojshme ligjore për transferimin e dokumentit elektronik në arkivin historik dhe nuk ekzistojnë kapacitetet e nevojshme për ruajtjen, evidencimin dhe shërbimin e dokumentit elektronik. Materializimi i këtij hendeku ligjor, kërkon gjithë përfshirje dhe impenjimin e AKSHI-t, Këshillit të Ministrave dhe DPA-së.

21.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave dhe AKSHI-n, duke u bazuar edhe në elementët e trajtuar në kreun V të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe vlerësuar nevojat institucionale, të ndërmarrë nismën e nevojshme për plotësimin me akte rregullatorë në lidhje me krijimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentit elektronik, veprim i cili do të ndihmonte jo vetëm Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, por të gjithë administratën publike e cila ka implementuar sisteme të teknologjisë së informacionit dhe ka një bazë të dhënash, të dhëna të cilat në të ardhmen do të jenë fond arkivor i DPA-së.

21.2. Nga auditimi rezulton që: DPA me shkresë nr.464/13 datë 12.03.2021 për këtë rekomandim ka marrë masa mbi ngritjen e grupit të punës për plotësimin me akte rregullatorë në lidhje me krijimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentit elektronik.

Rekomandimi është në proces zbatimi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës me nr. 1956/13 prot, datë 24.02.2020 me objekt: “Unifikim dhe shtim shërbimesh online për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave” të lidhur ndërmjet DPA dhe operatorit ekonomik “AS” shpk, u konstatua se:

- Për pjesën e mirëmbajtjes së sistemit mungojnë elementët e një e marrëveshjeje në nivel shërbimi në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike Nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

- Nga ana e operatorit ekonomik dhe nga grupet e marrjes në dorëzim nuk janë mbajtur raporte periodike të shërbimeve të kryera dhe raporte të disponueshmërisë së sistemeve, çka do të vërtetonte realizimin e procesit të mirëmbajtjes.
- Nuk ka dokumentacion vërtetues mbi realizimin e pikës nr. 2 të shërbimeve të kontratës “Trajnimi i përdoruesve”.

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në vijimësi të marrë masa për përfshirjen në kontratat e mirëmbajtjes së sistemit elementët e listuar në Udhëzimin nr. Nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, si dhe të dokumentojë shërbimin e marrë nëpërmjet raporteve periodike.

22.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka marrë masa duke ngritur grupin e punës, që në investimet e reja të përfshijë në kontratat e mirëmbajtjes së sistemit elementët e listuar në Udhëzimin nr. Nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, si dhe të dokumentojë shërbimin e marrë nëpërmjet raporteve periodike.

Rekomandimi është në proces zbatimi

23. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i ambienteve të arkivave shtetërore vendore në Lushnje, Rrëshen dhe Shkodër, u konstatua se:

- Nuk ka pajisje teknologjike për matjen e temperaturës dhe lagështirës (përjashtojmë këtu Arkivin Qendror), duke ndikuar në mungesën e monitorimit të vazhdueshëm të kushteve mikro-klimatike e për pasojë rëndimin e kushteve fizike për ruajtjen e dokumenteve, të cilat aktualisht janë jashtë standardeve të miratuara në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Ambientet e jashtme dhe të brendshme të godinave kanë lagështirë të konsiderueshme, si një nga elementët kryesorë të shkatërrimit të dokumenteve fizik e për pasojë humbjen e tyre në rastin më të keq, apo qoftë edhe vështirësi në procesin e dixhitalizimit.

- Godinat aksesohen nga punonjësit nëpërmjet hapjes së dyerve me çelës, ndërsa chip-i i përdorur shërben më shumë si kohëshënues i hyrje daljeve dhe jo si evidentim i personit që ka hyrë.

Check-in dhe evidentim i personelit kryhet vetëm në Arkivin Qendror, por edhe në këtë rast, hyrja është deri në nivelin e derës kryesore, dhe jo në nivel dhome ruajtjeje dhe kurrsesi në nivel dosjeje.

- Në vend ruajtjen e Rrëshenit nuk ka sistem për detektimin dhe fikjen e zjarrit.

23.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, duke marrë në konsideratë burimet e nevojshme dhe të disponueshme, të marrë masat e nevojshme, për përmirësimin e kushteve fizike të ruajtjes së dokumentacionit të arkivuar, duke implementuar edhe sisteme të teknologjisë së informacionit të cilat do të shërbenin për krijimin e standardeve optimale për ruajtjen e tyre.

23.2. Nga auditimi rezulton që: DPA ka me shkresë nr.464/13 datë 12.03.2021 marrë masa për ngritjen e punës, që në investimet e reja të implementohen edhe sisteme të teknologjisë së informacionit.

Rekomandimi është në proces zbatimi

Përmbledhëse e Masave Organizative

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime Gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
MASA ORGANIZATIVE	23	23	9	2	12	0

Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Drejtor i Përgjithshëm i DPA, z. A.B.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi rezulton se DPA ka zbatuar plotësisht 9 rekomandime, pjesërisht 2 rekomandime dhe në proces zbatimi 12 rekomandime.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju ri kërkohet** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se shërbimet që AKSHI duhet t’i ofrojë DPA-së nuk janë ende të rregulluara dhe përcaktuara në një marrëveshje të nënshkruar nga palët, me qëllim përcaktimin e nivelit të shërbimit që AKSHI duhet ti ofrojë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet dy institucioneve, në opinion të grupit të auditimit, përbën risk për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve të Drejtorisë TIK në DPA.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një marrëveshjeje dypalëshe mbi shkallën e suportit që njësia e IT dhe vetë AKSHI do t’i sigurojë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, me qëllim mirë përcaktimin e detyrimeve dhe përgjegjësisive të ndërsjella.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Auditit i Brendshëm në këtë institucion nuk ka planifikuar dhe kryer misionin auditimi në sistemet e TI-së, si dhe nuk ka zhvilluar burimet njerëzore me njohuri të mjaftueshme për auditimin e Teknologjinë së Informacionit.

2.1. Rekomandimi: DPA të marrë masa për zhvillimin e burimeve njerëzore të Auditit të Brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe mbulimin me auditim të brendshëm të sistemeve TI, drejtorisë TI në DPA si dhe përdoruesit e sistemeve informatike në përputhje me përcaktimet ligjore

Brenda vitit 2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si institucion i specializuar, që mbledh, përpunon, administron, ruan dhe shërben pasurinë arkivore në funksion të njohjes me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe e drejta për shërbim me dokumente për qëllime studimore-shkencore, nuk disponon një infrastrukturë BCC (Business Continuity Center). DPA nuk ka plan masash dhe procedurash për vazhdimësinë e proceseve dhe rimëkëmbjes nga katastrofat në rastet e dështimit të qendrës së të dhënave primare për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit, duke krijuar risk për humbjen e të dhënave, veprim në kundërshtim me pikën 1 të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave bashkëpunim me AKSHI-n, duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme, të marrë masa për ndërtimin e një Business Continuity Center dhe hartimin e Planit të Vazhdimësisë dhe Planit të Rikuperimit, duke përfshirë planet për backup dhe rimëkëmbjen nga katastrofat për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, hartimin e planit të sigurisë së informacionit dhe implementimin e tij.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPA nuk ka analizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat për trajnim të punonjësve për Sigurinë e Informacionit, në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.

4.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të hartojnë plane për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sigurinë e informacionit në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- DPA nuk ka një mekanizëm efektiv dhe të mirë dokumentuar të vlerësimit të riskut të sigurisë së informacionit.
- Vlerësimi i riskut i kryer nga DPA nuk mbulon të gjitha risqet e brendshme dhe të jashtme që vinë nga TI.
- DPA nuk mat efektet dhe ndikimet e mundshme të dëmtimeve në sigurinë e informacionit.
- DPA nuk ka mekanizma për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm.

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masa për hartimin e regjistrit të risqeve që kërcënojnë infrastrukturën TI si dhe ngritjen e mekanizmave për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk ka Politika të Sigurisë së Informacionit dhe një drejtim strategjik të përshtatshëm si mbështetje për sigurinë e informacionit.

6.1. Rekomandim: DPA të marrë masa për kalimin e sistemit të saj në domain gov që ofron AKSHI dhe të zbatojë Politikën e Sigurisë së Informacionit dhe drejtimin strategjik të këtij rrjeti.

Brenda vitit 2021

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Shërbimet e ofruara me anë të Teknologjisë së Informacionit në DPA mbështeten në një infrastrukturë IT (rrjeti network) të amortizuar, shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektivën e zhvillimeve të përcaktuara në planin strategjik 2020-2030.
- Ambientet e mbajtjes së serverave të DPA-së nuk plotësojnë kushtet teknike të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverëve” (versioni 1.0, datë 02.12.2008). Dhoma e serverave si vendi fizik ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverat dhe pajisje të tjera ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave është pika më e ndjeshme e sistemeve të teknologjisë së informacionit të një institucioni.

7.1. Rekomandim: DPA për mbështetjen e perspektivës së zhvillimeve institucionale të përcaktuara në planin strategjik 2020-2030 nga Teknologjia e Informacionit të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një infrastrukturë IT (rrjeti network dhe dhoma serverave) në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga AKSHI.

Brenda vitit 2021

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sistemi i hyrje daljeve DPA nuk garanton akses të sigurtë pasi në sistem rezultojnë

- Në 14 raste ka karta aksesi pa emër e mbiemër në sistem.
- Në 44 raste Llogari në akses pa emër ose përdorimi i numrave.
- Në 2 raste me status *active* pa të dhëna të plota.
- Në 3 raste me status *inactive* (data issue dhe aktivizimit e njëjtë).
- Në 9 raste pa status dy prej tyre kanë datë aktivizimi.
- Në 430 raste pa role përdorues.
- DPA nuk përdor sisteme TI për akses të kontrolluar sigurie të dhomave të arkivimit dhe rafteve.

Nga verifikimi i sigurisë në ambienteve të DPA dhe arkivave në rrethe rezultoi se:

- Siguria fizike në Godinat e DPA (ambientet e brendshme) ka risk të komprometohet, pasi mungesa e kamerave në ambientet e brendshme mbart riskun e humbjes së dokumenteve e modifikimit të tyre (rasti i humbjes së një vule në vitin 2019 dhe ri gjetjes së saj pa gjetur autorin).
- Niveli i përdorimit të Teknologjisë së Informacionit për krijimin e kushteve të nevojshme (temperaturës, lagështirës, mbrojtja kundër zjarrit dhe sigurisë) në ambientet e ruajtjen e dokumenteve është i ulët.

8.1. Rekomandimi:

1- DPA të analizojë nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar ndaj objekteve nëpërmjet:

- Ngritjes së një sistemi aksesi të përqendruar e të sigurt i cili duhet të përfshijë edhe aksesin e dhomave të arkivimit dhe rafteve
- Shtrirjes së kontrollit të ambienteve të brendshme dhe jashtme me sisteme CCTV.

2- DPA të marrë masa për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit në krijimin e kushteve të nevojshme në ambientet e arkivimit për mbajtjen e niveleve të duhura të temperaturës, lagështirës, si dhe sigurimit të mbrojtjes kundër zjarrit dhe sinjalizimit automatik të parametrave të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i fushave të plotësuara për user-at e katalogut, u konstatua se:

- Tek fusha “email”, i njëjti email është përdorur për dy user-a të ndryshëm.
- Në një rast, fusha “name”, është e plotësuar me një adresë email-i, e cila është e njëjtë me fushën “email”, duke mos ditur se cili është punonjësi me këtë user.

Nga verifikimi i fushave të plotësuara për user-at publik, u konstatua se:

- Në 19 raste, i njëjti individ paraqitet me dy numra letërnjoftimesh të ndryshme.
- Në 24 raste, i njëjti numër letërnjoftimi është përdorur për dy user-a të ndryshëm, duke evidentuar faktin se sistemi nuk e parandalon përdorimin e të njëjtit numër letërnjoftimi, fushë e cila është e vetmja që përfaqëson një të dhënë unike për përdoruesit, për disa user-a. Edhe pse nga verifikimi i detajuar, user-at me të njëjtën numër letërnjoftimi praktikisht janë i njëjti individ, fakti që ndryshon minimalisht një karakter, bën që sistemi të njohë si dy user-a të ndryshëm, çka vërteton se i njëjti numër letërnjoftimi mund të përdoret për dy apo më shumë user-a.
- Numri i letërnjoftimit, si fusha e vetme që përfaqëson një të dhënë unike për përdoruesit, e cila mund të bëjë identifikimin e tij, nuk ka mekanizëm kontrolli të input-it.

Në vlerësim të grupit të auditimit, elementët e mësipërm ndikojnë në rritjen e riskut të cenimit të sigurisë së sistemit, pasi user-at nuk janë unik, e për pasojë nuk janë plotësisht të identifikueshëm.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të analizojë elementët e pasaktësisë të user-ave dhe të marrë masa për eliminimin e tyre në vijimësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi me teknikat CAAT i të dhënave të katalogut dhe fototekës të vëna në dispozicion në formatin CSV si dhe testimet e sistemit, u konstatua se fushat “viti”, “numri i fondit”, “numri i inventarit”, “sasia e dosjeve”, “sasia e fletëve” dhe “numri i kutisë”, të cilat logjikisht duhet të përmbajnë numra, pranojnë si input-e edhe karaktere shkronja, çka tregon se sistemi nuk ka mekanizmat e nevojshme për kontrollin e input-it për këto fusha, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim evidentimin e të gjitha fushave të sistemit, të cilat kanë nevojë për vendosjen e mekanizmave për kontrollin e input-it dhe aplikimin e këtyre kontrolleve në sistem.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk ka një rregullore të miratuar për ruajtjen, kontrollin dhe analizimin periodik të log-eve të sistemit, me

qëllim verifikimin e ndërhyrjeve të pa autorizuar, dhe parandalimin e veprimeve të cilat mund të komprometojnë të dhënat e administruara nga DPA. Log-et e sistemeve analizohen vetëm nëse ka ndonjë raportim për ndonjë incident në rrjet.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë masat për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje për ruajtjen, kontrollin dhe analizimin periodik të log-eve të sistemit, me qëllim verifikimin e ndërhyrjeve të pa autorizuar, dhe parandalimin e veprimeve të cilat mund të komprometojnë të dhënat e administruara nga DPA.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nisur nga vlerësimi i strategjisë institucionale, si dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e teknologjisë së informacionit, konstatohet se ka mos përditësim apo mungesë e akteve rregullatorë në lidhje me krijimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentit elektronik. Në kreun V të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, evidentohen elementë për dokumentet e numerizuara. Për sa i përket procesit që DPA zhvillon, grupi i auditimit vlerëson se kjo bazë ligjore ka nevojë për plotësime, ndryshime apo përshtatje me situatën aktuale të zhvillimit teknologjik, pasi nuk ekziston e gjithë baza e nevojshme ligjore për transferimin e dokumentit elektronik në arkivin historik dhe nuk ekzistojnë kapacitetet e nevojshme për ruajtjen, evidencimin dhe shërbimin e dokumentit elektronik. Materializimi i këtij hendeku ligjor, kërkon gjithë përfshirje dhe impenjimin e AKSHI-t, Këshillit të Ministrave dhe DPA-së.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave dhe AKSHI-n, duke u bazuar edhe në elementët e trajtuar në kreun V të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe vlerësuar nevojat institucionale, të ndërmarrë nismën e nevojshme për plotësimin me akte rregullatorë në lidhje me krijimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentit elektronik, veprim i cili do të ndihmonte jo vetëm Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, por të gjithë administratën publike e cila ka implementuar sisteme të teknologjisë së informacionit dhe ka një bazë të dhënash, të dhëna të cilat në të ardhmen do të jenë fond arkivor i DPA-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës me nr. 1956/13 prot, datë 24.02.2020 me objekt: “Unifikim dhe shtim shërbimesh online për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave” të lidhur ndërmjet DPA dhe operatorit ekonomik “AS” shpk, u konstatua se:

- Për pjesën e mirëmbajtjes së sistemit mungojnë elementët e një e marrëveshjeje në nivel shërbimi në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike Nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

- Nga ana e operatorit ekonomik dhe nga grupet e marrjes në dorëzim nuk janë mbajtur raporte periodike të shërbimeve të kryera dhe raporte të disponueshmërisë së sistemeve, çka do të vërtetonte realizimin e procesit të mirëmbajtjes.

- Nuk ka dokumentacion vërtetues mbi realizimin e pikës nr. 2 të shërbimeve të kontratës “Trajnimi i përdoruesve”.

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në vijimësi të marrë masa për përfshirjen në kontratat e mirëmbajtjes së sistemit elementët e listuar në Udhëzimin nr. Nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, si dhe të dokumentojë shërbimin e marrë nëpërmjet raporteve periodike.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i ambienteve të arkivave shtetërore vendore në Lushnje, Rrëshen dhe Shkodër, u konstatua se:

- Nuk ka pajisje teknologjike për matjen e temperaturës dhe lagështirës (përfshirë këtu Arkivin Qendror), duke ndikuar në mungesën e monitorimit të vazhdueshëm të kushteve mikro-klimatike e për pasojë rëndimin e kushteve fizike për ruajtjen e dokumenteve, të cilat aktualisht janë jashtë

standardeve të miratuara në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Ambientet e jashtme dhe të brendshme të godinave kanë lagështirë të konsiderueshme, si një nga elementët kryesorë të shkatërrimit të dokumenteve fizik e për pasojë humbjen e tyre në rastin më të keq, apo qoftë edhe vështirësi në procesin e dixhitalizimit.

- Godinat aksesohen nga punonjësit nëpërmjet hapjes së dyerve me çelës, ndërsa chip-i i përdorur shërben më shumë si kohëshënues i hyrje daljeve dhe jo si evidentim i personit që ka hyrë.

Check-im dhe evidentim i personelit kryhet vetëm në Arkivin Qendror, por edhe në këtë rast, hyrja është deri në nivelin e derës kryesore, dhe jo në nivel dhome ruajtjeje dhe kurrsesi në nivel dosjeje.

- Në vend ruajtjen e Rrëshenit nuk ka sistem për detektimin dhe fikjen e zjarrit.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, duke marrë në konsideratë burimet e nevojshme dhe të disponueshme, të marrë masat e nevojshme, për përmirësimin e kushteve fizike të ruajtjes së dokumentacionit të arkivuar, duke implementuar edhe sisteme të teknologjisë së informacionit të cilat do të shërbenin për krijimin e standardeve optimale për ruajtjen e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shënim: Ju lutemi, merrni masat që Raporti i Auditimit, t'ju komunikohet të gjithë personave të interesuar të përmendur në të, në mënyrë që të kenë mundësinë, të paraqesin brenda afatit komentet dhe shpjegimet e tyre.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT